



Deklaratat e analizuarra:

14 Deklarata të analizuarra

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2004 deri Periodik/Vjetor 2016)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2016



rritja e pasurisë bruto është 7.3 herë

+ 812,892 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të ardhurat	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	17,019,085	74.2%
Paga e bashkëshortes	5,195,539	22.7%
Mësimdhënia	380,251	1.7%
Të ardhura të tjera	330,320	1.4%
Total	22,925,195	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 13 vite rezultoi:

Pa probleme.



Në vitin 2005 subjekti ka deklaruar blerje apartamenti me vlerë 50.292 euro, nga e cila është paguar 40.000 euro me burim pjesërisht me kursimet ndër vite, me hua në shumën 12.000 euro dhe pjesërisht me kredinë e marrë për këtë qëllim. Kredia e marrë për blerjen e apartamentit është në shumën 5.000.000 lekë, kredi shtetërore, por vetëm 1.500.000 lekë është përdorur, pasi diferenca prej 3.500.000 lekësh është mbajtur në llogari bankare të subjektit deri në vitin pasardhës. Në vitin 2005 kjo llogari është pakësuar plotësisht dhe është përdorur për kthimin e huasë prej 12.000 euro, detyrimin e mbetur pa paguar të shoqëria sipërmarrëse, si dhe mobilim.